



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 19.12.2022

Nr: 24

Ora: 12:30

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 10, NR. 11,
KËRKESËS NR. 04 TË KOMISIONERIT SHTETËROR TË ZGJEDHJEVE DHE
PEZULLIMIN E SHQYRTIMIT**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 19.12.2022, me pjesëmarrjen e:

Koli Bele	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Elvis ÇEFA	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Ledio Braho	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES:

1. Partia Demokratike e Shqipërisë
2. Partia Republikane e Shqipërisë
3. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

OBJEKT:

1. Kundërshtim i vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Mbi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021".

2. Kundërshtim i vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Mbi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021.

3. Kërkesë për vendosje sanksioni administrativ

BAZË LIGJORE:

Nenet 21, 123/1, 124/1, 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, neni 34, shkronja “b” dhe neni 35 të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Partia Demokristiane e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 10 regj., datë 09.12.2022. Në mbledhjen e datës 19.12.2022, ora 12:30, pas relatimit të z. Koli Bele u konstatua se kërkesa ankimore nr. 10 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Partia Republikane e Shqipërisë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 11 regj., datë 12.12.2022. Në mbledhjen e datës 19.12.2022, ore 12:30, pas

relatimit të z. Elvis Çefa u konstatua se kërkesa ankimore nr. 11 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i është drejtuar Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve me kërkesën për vendosje sanksioni, pas daljes së vendimit nr. 224 datë 07.12.2022 “Mbi miratimin e raportit të gjetjeve nga auditimi i fondeve publike të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike pjesëmarrëse në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, datë 25.04.2021”, e cila në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 127, të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e kërkesave të KSHZ drejtuar KAS-it, me nr. 04 regj., datë 14.12.2022. Në mbledhjen e datës 19.12.2022, ora 12:30, pas relatimit të z. Ilirjan Rusmali u konstatua se kërkesa ankimore nr. 04 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

Duke qenë se në vendimin nr. 224 datë 07.12.2022 të KSHZ preken interesat e ligjshme për disa parti politike dhe se afati i ankimit për këtë vendim është 30 ditë dhe mund të ketë dhe kërkesa ankimore nga subjekte të tjera, KAS vlerëson se duhet pezulluar shqyrtimi me objektin e sipërcituar derisa të përfundojë afati i ankimit 30 ditë për të gjitha partitë politike dhe më pas të shqyrtohet në një vendim të vetëm. Në zbatim të nenit 19, pika 1, të vendimit nr.03, datë 06.11.2020 “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, përcaktohet se, *KAS përpara ose gjatë shqyrtimit të një ankimi administrativ, vendos shqyrtimin bashkërisht të tij me një ose më shumë ankime të tjera, të paraqitura nga subjekte të ndryshme kundër të njëjtit vendim.....*

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 21, pika 1, shkronja “b” dhe “dh” , 126 dhe 130 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 10, datë 09.12.2022, të paraqitur nga Partia Demokristiane e Shqipërisë, dhe nr. 11, datë 12.12.2022, të paraqitur nga Partia Republikane Shqiptare dhe kërkesës nr. 04, datë 14.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve për vendosje sanksioni administrativ;
2. Pezullimin e shqyrtimit administrativ deri në përfundim të afatit të ankimit 30 ditor të vendimit nr. 224, datë 07.12.2022 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Koli BELE - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Elvis ÇEFA - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**